



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.198/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me të cilën kërkohet që ti shqiptohet dënimi me gjobë ndaj subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të bërjes së fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur.

A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 12.10.2017, me të cilën pretendon se kryetari i subjektit politik PDK Kadri Veseli në profilin e tij zyrtar në facebook ka shpërndar një fotografi nga tubimi zgjedhor me gratë e PDK-së. Sipas parashtruesit të ankesës nga tubimi zgjedhor i mbajtur shihet se ka edhe fëmijë. Parashtruesi i ankesës thekson se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 5.1 të Rregullës zgjedhore 13/2013 që ndalon përfshirjen e personave nën 18 vjet në fushate.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotot e postuara nga faqja publike e kryetarit të PDK-së.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik PDK, të datës 13.10.2017, theksohet se ankesa në fjale është e pabazuar, pasi që nuk thirret në asnjë dispozitë ligjore por vetëm se deponon fotografi nga një tubim i mbajtur me femra në Drenas. I njëjti thekson se fotoja ku shihet një nënë me fëmijë e vet nuk ka cilësohet si shkelje e kodit të mirësjelljes sepse fëmijë është në prehën të nënës e cila ka marrë vete pjesë në fushate andaj propozon që ankesë ta hudhe si të pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore dhe provat e bashkangjitura erdhe në përfundim se pretendimet në ankesë janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi për faktin se nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet se ka elemente të fushatës zgjedhore me fëmijë pasi që fëmija ka qenë nën shoqërim të prindit dhe se nga kjo nuk mund të konstatohet se fëmija është përdorur për fushatë zgjedhore dhe se në këtë rast nuk ka elemente të fushatës zgjedhore me fëmijë të mitur ashtu si pa bazë theksohet në ankesë.

Andaj, paneli erdhi në përfundim se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e tij në mënyrë që paneli të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr. 198/2017 më datën 16.10.2017.



Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.